



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.02.2026, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: Drejtorët komunal, Ganimete Aliu, UD-së Njësisit Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

RENDITE

1. Aesytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i propozimit të DIL-së nr.17-104-02-4418-26 e dt.12.02.2026 për bartjen e mjeteve nga projektet e planifikuara kapitale në projektin e ndërtimit të QKMF-së, në Obiliq.
4. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit me nr.01-06-01-17633-25 për themelimin e mekanzimit lokal koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjjinore
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e propozimit të DIL-së nr.17-104-02-4418-26 e dt.12.02.2026 për bartjen e mjeteve nga projektet e planifikuara kapitale në projektin e ndërtimit të QKMF-së, në Obiliq.

Fjolla Nasufi – Jo, nuk kemi diçka për të shtuar në këtë pikë të rendit të ditës.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Jo, nuk kemi diçka për të shtuar, por le ti rekomandohet Kuvendit Komunal pastaj atje do të diskutojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Drejtoria për Infrastrukturë Lokale me nr.17-104-02-4418-26 e dt.12.02.2026 për bartjen e mjeteve nga projektet e planifikuara kapitale në projektin e ndërtimit të QKMF-së, në Obiliq.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore për plotësim ndryshim të vendimit nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025 për Themelimin e Mekanizmit Lokal Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në bazë Gjinore. Për shkak të ndryshimeve që janë bërë të strukturës komunale, kërkohet të ndryshohet vendimi të emri i ish Kryetarit të Komunës dhe të emri i ish- drejtoreshës së shëndetësisë.

Fjolla Nasufi – Jemi dakord me këtë pikë që ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

Vlora Kabashi Kabashi – Pajtohem që ti rekomandohet Kuvendit Komunal si pikë e rendit të ditës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore për plotësim ndryshimin e vendimit nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se nga MAPL-ja i kemi disa dokumente që duhet ti rishqyrtojmë. E kemi rishqyrtimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete. Në seancën e kaluar, kur e kemi formuar Komitetin për Komunitete, ka pasë dy propozime nga grupi i LDK-së, që në rundin kur ka qenë edhe z.Enver Gashi i propozuar është bërë një lëshim nga ana ime gjatë numërimit të votave, dhe unë kam konstatuar se janë 9 vota për dhe 9 vota kundër. Në ndërkohë, pas ankesës së z.Enver Gashi dhe shikimit të videove është parë se ka qenë gabimi im dhe vendimin e kemi dërguar me emrin e z.Enver Gashi, sepse fillimisht ka marrë vota më shumë. Megjithatë, MAPL-ja, e ka kthyer vendimin për rishqyrtim, për shkak se nuk është plotësuar kuota gjinore.

Labinot Mirena - Unë sa e di, kjo është me Kuvend, 5 me 2 numri dhe pyes se a hynë edhe ata jashtë Kuvendit, që propozohen sipas gjinisë apo jo.

Kryesuesi - Sqaron nëse, ju kujtohet ne e kemi pasë një diskutim edhe me ish kryesuesen që kemi biseduar në seancë për këtë çështje. Ne kështu e kemi vlerësuar por MAPL-ja e ka rrvlerësue ndryshe, që duhet të llogaritet numri i përgjithshëm prej 9 personave që zgjedhen të jenë të paktën 4 të gjinisë femërore.

Abdyrrahman Krasniqi – Pse nuk shikoni kryesues të ndërroni dikë që është jashtë Asamblesë Komunale që janë propozuar, që të ketë një gjithëpërfshirje që me pas prej tyre të gjinisë femërore, por vetëm prej Asamblesë.

Kryesuesi – Tash, mbledhjet janë mbajtur dhe është kryer ai proces, dhe neve na kanë vënë para aktit të kryer, sepse kanë sjellë emra që i kanë zgjedhur Komisionet e tyre dhe është problem tash me i thirrë edhe një herë.

Ganimete Aliu - Në bazë të Ligjit për barazi gjinore nëse shkoni me 9 anëtarë është 5 me 4 prej cilësdo gjini, dhe nëse shkoni me 7 anëtarë është 4 me 3 kështu që kjo duhet të respektohet, sepse prapë MAPL-ja e kthen vendimin.

Abdyrrahman Krasniqi – Dua një sqarim ose ndonjë Rregullore që kemi ne për shembull që e përcakton sepse ne e dijmë se kuota përcaktohet me 30 %. Nëse janë 9 anëtarë në këtë Komitet të zgjedhur dhe prej tyre janë 3 femra dhe 6 meshkuj, atëherë unë besoj se ne e kemi tejkaluar kuotën. Në këtë rast nëse, z.Enver vendos të marrë avokat të shkoj përmes Gjykatës mendoj se ai ka të drejtë në këtë pikë sepse janë 6 me 3. Unë vetëm kisha dashtë në njëfarë mënyre me elaborue sa më mirë dhe me ardhë të një përfundim që nëse është votimi në rregull le të mbetet ai, por nëse nuk është ky mund të shkoj me hapa të mëtutjeshëm dhe me na krijue sfida të reja.

Kryesuesi – Ne në mbledhjen e Kuvendit do të vijmë me të gjitha informacionet, megjithatë është Ligji për barazi gjinore që e cakton dhe në këtë rast nuk është 30 %-i, por 50 %-i. Është një lëshim nga ana ime që kërkoj mirëkuptimin tuaj se ndoshta nuk i kam kushtue rëndësi kësaj pjese me mendimin se bëjmë,

propozime racionale dhe problemi është se vetëm shtyhet për një muaj çështja e aktivizimit të këtij Komiteti.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal rishqyrtimin e vendimit me nr. 01-060-01-3053, të dt.02.02.2026 për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi – Paraqiti rishqyrtimin e vendimit për zjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për komunitete. Ne kemi bërë një shkelje procedurale sepse sipas LVL-së, Statutit dhe akteve tjera Nënkyetari për komunitete duhet të zgjedhet nga shumica e Kuvendit dhe nga shumica e pakicave që janë të përfaqësuara në Kuvend. Në këtë rast është dashur të jenë së paku 11 vota dhe ky votim shkon me dy runde. Në rundin e parë shkon për krejtë anëtarët ndërsa, rundi i dytë shkon vetëm për pakicat. Në këtë rast asnjë votë nuk ka qenë prej komuniteteve në ndërkohë që ka kaluar me 15 vota tona, por në mbledhjen e Kuvendi provohet edhe një herë ky vendim në të kundërtën shfuqizohet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal, rishqyrtimin e vendimit nr.01-060-01-2982-26 i dt.30.01.2026 për emërimin e Nënkyetarit për Komunitete.

Kryesuesi – E kemi vendimin që është marrë në seancën e kaluar për ndërrimin e emrit të operatorit ekonomik "Nic Home" SH.P.K. që sipas MAPL-së, kjo është kompetencë e Ekzekutivit dhe Kuvendi nuk mund të bëjë asnjë ndryshim në këtë drejtim. Në të ardhmen dokumentet që vijnë nga MAPL-ja, ne do të iu dërgojmë juve për transparencë. Unë propozoj ti rekomandojmë Kuvendit shfuqizimin e vendimit që e kemi marrë për operatorin "Nic Home".

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-2992-26 i dt.30.01.2026, Nic Home SH.P.K.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Ashtu siç biseduam lidhur me këtë pikë të rendit të ditës në mbledhjen e KPF-së, sepse nganjëherë edhe kur dëshiron të flasësh, për të mos gabuar tjetri, në mënyrën që ke bërë ti sikur po merret si kundërshtim politik, por unë ua sqarova se të njejtën çështje e kam pasë dhe MAPL-ja, e ka kthye për shfuqizim sepse këto janë kontrata të negocijuara, dhe Kuvendi nuk ka të drejtë të merrë vendime të tilla.

Kryesuesi – Po ashtu, e kemi vendimin e Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjse së mbeturinave KRM "Pastrimi" ku është kërkuar të shtohet baza ligjore, në preambulë dhe është kërkuar që të potencohet se ku do të merren mjetet për pagesën e aksionarëve.

Labinot Mirena – Në legjislaturën e kaluar kemi marrë vendim për pagesën e aksionarëve që të bëhet nga Ndërmarrja, por edhe për vendimin e NPL "Kastrioti" pagesa e aksionarëve duhet të bëhet në bazën mujore, sepse ata janë duke e pritë vendimin sikurse KRM "Pastrimi".

Abdyrrahman Krasniqi - Nëse mundemi me përcaktu edhe pagën minimale me vendim, në mënyrë që të tejkalohen disa mjegullina që janë gjatë këtyre proceseve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal plotësim ndryshimin e vendimit nr.01-060-01-2996-26, i dt.30.01.2026 KRM "Pastrimi".

Kryesuesi – Të njejtën gjë duhet ta bëjmë edhe për NPL "Kastrioti".

Vlora Mjekiqi Kabashi – Pyeti se a ke marrë diçka nga Ministria lidhur me këtë vendim.

Kryesuesi – Sa i përket këtij vendimi është konfirmuar ligjshmëria, por as në mandatin e kaluar nuk ka qenë se janë paguar, prandaj për arsye të transparencës, propozoj të marrim një vendim që të sqarojmë burimin e mjeteve që merren për kompensimin e tyre.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal plotësimin e vendimit nr.01-060-01-39150-25, i dt.31.12/25 NPL "Kastrioti".

Kryesuesi – Ne kemi marrë 2 kërkesa nga Zymer Morina, njëra është për emërimin e shkollës fillore në Milloshevë në emër të Fidaim dhe Shkëlzen Morina. Unë ju kam thënë se çdo kërkesë që vjen do e trajtojmë ,ajo që ju kam thënë është gabim,sepse është përzierje në kompetencat e të tjerëve. Unë e

tërheqi fjalën time sepse disa kërkesa që vijnë që nuk kanë të bëjnë me Kuvendin, ne nuk kemi nevojë Kuvendin me vënë në lajthitje me votue diçka që nuk ka të bëjë me Kuvendin.

Sevdije Berisha – Sipas Udhëzimit Administrativ nr.102/2020 për emërtimin e institucioneve publike, neni 2 e përcakton këtë çështje, por paraprakisht është një procedurë që duhet të inicohet nga Këshilli drejtues i shkollave përkatëse. Po ashtu, te emërtimi i shkollës mendoj se duhet të ketë një debat publik para se të vjen në Kuvend.

Fjolla Nasufi – Ne e mbështesim mendimin e drejtoreshës.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Për mua është shumë në rregullë, sepse këto gjëra i kam ditë qysh më heret dhe kështu kemi vepruar.

Kryesuesi - Kërkesa e dytë nga Zymer Morina është për emërtim të çerdhes dhe për këtë fjalën ia japë drejtoreshës së Arsimit.

Sevdije Berisha – Shpjegimi është i njëjtë për të gjitha institucionet edukative arsimore, procedura është e njëjtë, do të thotë shkon përmes Këshillit drejtues të shkollave, adresohet në DKA pastaj direkt në Ministri të Arsimit.

Kryesuesi – Ju lus që palët të marrin një përgjigje zyrtare, sepse ekziston edhe një afat ligjor për dhënien e përgjigjes ndaj kërkesave që bëhen.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DKA-së kërkesën me nr.-I-2392/96 të dt.26.01.2026 dhe kërkesesën me nr. -I- 2392/26 e dt.26.01.2026 nga Zymer Morina dhe DKA-ja, të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga operatori ekonomik Vjosa SH.P.K. për marrjen e një prone publike në shfrytëzim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DPUKP-së, kërkesën me nr.II-2977/26 të dt.26.01.2026 Vjosa SH.P.K.dhe DPUKP të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga SH.P.K. Kastrioti për transport publik për subvencionim.

Besnik Krasniqi – Ne si Drejtori e financave e kemi shqyrtu kërkesën, dhe sa i përket anës buxhetore nuk është e paraparë për financim. Ne do të iu kthejmë këtyre një përgjigje në email.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DSHPE-së, kërkesën me nr.-I-3230/26 e dt.03.02.2026 Kastrioti SH.P.K. dhe DSHPE të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Pika 6 e rendit të ditës


Kryesuesi – Ju njoftoj se dje kam marrë një email prej znj.Fitore Hashani, e cila konfirmon se dje është mbajtur një mbledhje, dhe grupin e LDK-së do ta përfaqësoj ajo.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Po kryesues para 2 dite, kemi mbajtur një mbledhje ku unë vetë kam kërkuar që të mos jem më shefe e LDK-së, të zëvendësohem nga dikush tjetër dhe tani me shumicën e votave është znj.Fitore Hashani.

Kryesuesi – Pasi që askush nuk ka të shtoj diçka edhe e mbylli seancën e Komitetit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:33'

Zyrtare e lartë për punë të KK


Azize Zeneli

